

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E RUAJTJES DHE SIGURISË TË SUT-SË ME ROJE PRIVATE

Përshkrimi i kërkesave për zbatimin e shërbimeve:

1. Punonjësit e shërbimit të jenë të licencuar me lejet përkatëse të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të ligjit 75/2014, datë 10.07.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike,„
2. Të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre.
3. Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi ose mjete alternative komunikimi.
4. Vendrojet e shërbimit 24 orësh të jenë të pajisur me armë.
5. Në vend roje të ketë libër për marrjen dhe dorëzimin e shërbimit i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.
6. Në vend roje duhet të jetë i afishuar grafiku i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.

Detyrat e kontraktorit:

1. Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t’ia paraqesë autoritetit kontraktor.
2. Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t’ia paraqesë çdo muaj autoritetit kontraktor (AK) duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe turn.
3. Të ndërhyjë me grupin e gatshëm në bazë të legjisllacionit në fuqi në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.
4. Kontraktori është përgjegjës dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e objekteve dhe bazës materiale që ndodhet në inventar në territorin e Spitalit.
5. Kontraktori është përgjegjës dhe mban përgjegjësi me dëmshpërblim për të gjithë bazën materiale që dëmtohet gjatë kohës së kryesjes së shërbimit në ambientet e brendshme të SUT-së.
6. Shërbimi duhet të kryhet gjatë gjithë afatit të kontratës (çdo ditë), 24 orë në ditë dhe pa ndërprerje.
6. Kontraktori është përgjegjës dhe mban përgjegjësi (në rast vjedhjeje me dëmshpërblim) për ruajtjen e të gjithë automjeteve të personelit të SUT të pajisur me autorizim nga Drejtoria e Spitalit që ndodhen në territorin e SUT.
7. Kontraktori është përgjegjës dhe mban përgjegjësi (në rast dëmtimi me dëmshpërblim ose zëvendësim) për ruajtjen e të gjithë infrastrukturës (vetrata xhami, dyer, stola, kosha mbeturinash) që përfshin dhe ndodhet në territorin e SUT.

Detyrat e punonjësit të shërbimit:

1. Të zbatojë rregulloren e shërbimit të hartuar nga drejtuesi teknik.
2. Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të SUT.
3. Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.
4. Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në objekte.
5. Të kujdeset për ndricimin e jashtëm të objektit dukë venë në dijeni përgjegjës të tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të AK për çdo mangësi të konstatuar.
6. Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzues dhe për çrregullimet e konstatuara njofton përgjegjës të rojeve dhe përgjegjës të shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënime përkatëse në librin e shërbimit.
7. Të njohë dhe të zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit.
8. Të jetë i pajisur me armë (Vendrojet e shërbimit 24 orësh) dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
9. Të karakterizohet nga sjellja korrekte në komunikim me personat.
10. Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cenimit të institucionit ose të personelit.

I. Vendroja Nr. 1. Postblloku Kryesor i SUT – 3(tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Portën hyrëse kryesore të SUT.
2. Zyrat e Shërbimit 24 orësh (ish-Mjeku kordinator, shoferi i shërbimit).
3. Murin rrethues nga Porta e hyrjes kryesore deri tek pjesa perëndimore e Ambulancës (Poliklinikës).
4. Pjesën lindore të ndërtesës së Sëmundjeve të Brendshme.
5. Zyrat e Firmës Private “SORI-AL” mbi zyrat e Shërbimit të ish-Mjekut Kordinator dhe zyrën e Mjekes Dietologe.

Ka për detyrë:

1. Ruajtjen e objekteve të caktuara.
2. Nuk lejon persona të futen në SUT nga muri rrethues.
3. Në portën kryesore të SUT, lejohen të futen automjetet e Administratës së SUT, automjetet e personaliteteve të larta shtetërore, Presidenti Republikës së Shqipërisë, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Ministra, Zv/Ministra, Deputet, Gjeneral të FA, Përsoneel i Ministrisë së Shëndetësisë, dhe i Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA.
4. Në portën kryesore të SUT, futen në çdo kohë automjetet, që sjellin pacient në urgjencën e SUT.
5. Në asnjë rast nuk duhet të lejojë parkimin e automjeteve në rrugën kryesore që të çon në urgjencën e SUT.
6. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
7. Kontrollin për mbylljen dhe vuloşjen e objekteve.

8. Kur vëren se në Vr.Nr. 1, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.

II. Vendoja Nr.2. Shërbimi Ambulator i SUT – 3 (tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Portën hyrëse Nr. 2 të SUT.
2. Ndërtesën Kryesore dykatëshe të Ambulancës (Poliklinikës).
3. Murin rrethues nga Porta hyrëse Nr.2 deri tek pjesa perëndimore e në fillim të ndërtesës dy katëshe të laboratorit dhe Statistikës. Murin rrethues në pjesën jugore të Ambulancës nga porta hyrëse Nr.2 deri tek pjesa jugperëndimore e Ambulancës.
4. Ndërtesën në perdorim të Institutit të mjeksisë ligjore.
5. Pjesën Jugore e Lindore të Ndërtesës së Kirurgjisë Rikonstruktive.
6. Pjesën Lindore të Zyrrave të Administratës
7. Pengesat me zinxhirë.

Ka për detyrë:

1. Ruajtjen e objekteve të caktuara.
2. Kontrollon Autorizimet për hyrjet e Automjeteve punonjësve të SUT në Parkingun kryesor të SUT dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e tyre.
3. Nuk lejon persona të futen në SUT nga muri rrethues.
4. Në portën hyrëse Nr.2 të SUT, lejohen të futen automjetet e Administratës së SUT, automjetet e ndryshëm që vijnë me pacientë
5. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
6. Kontrollin për mbylljen dhe vulosjen e objekteve.
7. Në parkun e ullishteve lejohet parkimi vetëm për automjetet e personelit të SUT, dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e tyre.
8. Kur vëren se në Vr.Nr.2, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve..
9. Kryen detyrën me patrullim.

III. Vendoja Nr.3. Parku i SUT 3 (tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Parkun e SUT.
2. Krematoriumin e djegies.
3. Ndërtesën një katëshe të parkut, ish trupprojën e ushtarëve aktiv.Ndërtesën dy katëshe të ish Infektivit.
4. Zyrrat e ndërtesës dy katëshe të laboratorit dhe Statistikës, katin e I-rë dhe të II-të.
5. Murin rrethues nga pjesa lindore e Krematoriumit deri në pjesën lindore të ndërtesës së vjetër të ish-Infektivit.
6. Pengesat me zinxhirë.

Ka për detyrë:

1. Ruajtjen e objekteve të caktuara.
2. Nuk lejon automjete të huaja të futen në Park, përvec automjeteve të SUT-së.
3. Nuk lejon persona të futen në SUT nga muri rrethues.
4. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
5. Kontrollin për mbylljen dhe vulosjen e objekteve.
6. Në bashkëpunim me rojen në Vendrojen Nr.2 në parkun e ullishteve të lejojë parkimin vetëm për automjetet e personelit të SUT, dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e tyre
7. Kur vëren se në Vr.Nr.3, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
8. Kryen detyrën me patrullim.

IV. Vendroja Nr.4. Oksigjeni i SUT – 3 (tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Bombolat e Oksigjenit të SUT.
2. Çisternën e Karburantit.
3. Depot e Ujit të SUT.
4. Pjesën Veriore të Reanimacionit, Shërbimit të Radiologjisë, Skanerin.
5. Ndërtesën një katëshe në pjesën perëndimore të SUT.
6. Murin rrethues nga pjesa e ndërtesës së vjetër të Infektivit të vjetër deri tek pjesa perëndimore e Shërbimit të Urgjencës së SUT.
7. Pengesat me zinxhirë.

Ka për detyrë:

1. Ruajtjen e objekteve të caktuara.
2. Nuk lejon automjete të huaja të afrohen tek bombolat e oksigjenit, çisternat e karburantit, përvec personelit të SUT, që janë të paisur me dokumenta përkatëse (Fletë Hyrje).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
4. Kontrollin për mbylljen dhe vulosjen e objekteve.
5. Nuk lejon persona të futen në SUT nga muri rrethues.
6. Ndalimin e grumbullimit të personave përpara derës së Reanimacionit dhe mos lejimin e tyre brenda në pavion.
7. Kur vëren se në Vr.Nr.4, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
8. Kryen detyrën me patrullim.

V. Vendroja Nr.5. Sheshi tek Urgjenca e SUT 3 (tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Murin rrethues nga pjesa perëndimore e Shërbimit të Urgjencës së SUT pjesën jugore para Urgjencës së SUT deri tek Ndërtesa e Sëmundjeve të brendshme.

2. Parkingun e personelit përballë Urgjences.
3. Katin e parë nga jashtë të ndërtesës së Urgjences, katin e parë të Shërbimit të Ortopedisë civile.
4. Pistën e uljes së helikopterëve.
5. Pengesat me zinxhirë.

Ka për detyrë:

1. Ruajtjen e objekteve të caktuara.
2. Nuk lejon persona të futen në SUT nga muri rrethues.
3. Nuk lejon parkimin e Automjeteve në pistën e uljes së helikopterëve, në sheshin përpara urgjencës, në rrugëkalimet tek urgjenca.
4. Kontrollon autorizimet për hyrjet e automjeteve të punonjësve të SUT në parking dhe mban përgjegjësi për ruajtjen e tyre.
5. Në bashkëpunim me vendrojen Nr. 7 tek sheshi kryesor, udhëzojn automjetet me shpejtësi të lartë në rast urgjence për rrugën dhe vendndodhjen e urgjencës.
6. Kur vëren se në Vr.Nr.5, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
7. Kryen detyrën me patrullim.

VI. Vendroja Nr. 6. Ambientet e Brendshme të Urgjencës 3 (tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Urgjencës (dhoma e mjekimit, dhoma e observacionit, dhoma e grafisë, dhoma e EKO, dhoma e allcisë, sallat e operacionit të traumës, sallat e ORL, urgjenca e terapisë).

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Urgjencës.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në ambientet e Urgjencës.
3. Moslejimin e grumbullimit të personave përpara derës së Reanimacionit që përdoret nga personeli.
4. Bashkëpunimi me efektivat e Policisë së Shtetit në interes të rritjes së shkallës së sigurisë dhe parandalimit të ngjarjeve të jashtëzakonshme.
5. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve
6. Kur vëren se në Vr.Nr.6, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
7. Kryen detyrën me patrullim.

VII. Vendroja Nr.7. Sheshi Kryesor i SUT 3 (tre) turne – 24 orë.

Ka në ruajtje:

1. Zyrat e magazinën e Farmacisë së SUT.
2. Pjesën perëndimore të Ndërtesës së Kirurgjisë Rekonstruktive, Zyrat e Drejtorisë së SUT, Zyrat e Administratës së SUT, Sekretarinë Sekrete, Zyrat e Personelit, Zyrat e Specialistëve të Shërbimeve, Zyrat e KUMI-it, Zyrat e Radiologjisë, Korridorin e radiologjisë, ECHO-n, Shërbimin e Fizioterapisë, magazinat e llogjistikës, sallën kryesore të SUT.
3. Pjesën Veriore dhe Perëndimore të ndërtesës së Sëmundjeve të brendshme.
4. Murin rrethues nga prapa ndërtesës së Sëmundjeve të brendshme.

Ka për detyrë:

1. Ruajtjen e objekteve të caktuara.
2. Nuk lejon persona të futen në SUT nga muri rrethues.
3. Nuk lejon parkimin e Automjeteve private në Sheshin kryesor të SUT.
4. Në sheshin kryesor të SUT, lejon parkimin e automjeteve shtetërore të SUT, makinat e Personaliteteve të larta shtetërore që vijnë në SUT.
5. Në asnjë rast nuk duhet të lejojë parkimin e automjeteve në rrugën kryesore që të çon në urgjencën e SUT.
6. Në bashkëpunim me vendrojen Nr. 5 tek sheshi i urgjencës, udhëzojnë automjetet me shpejtësi të lartë në rast urgjence për rrugën dhe vendndodhjen e urgjencës.
7. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
8. Kontrollin për mbylljen dhe vulosjen e objekteve.
9. Kur vëren se në Vr. Nr.7, ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
10. Kryen detyrën me patrullim.

VIII. Vendroja Nr.8. Porta e Sallave të Bllokut Operator 8 orarësh- Turn i parë – Orar zyrtar,

Të shtunë, Të Dielën dhe ditët zyrtare të festave Pushim.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Bllokut Operator.

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Bllokut Operator.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në koridor dhe futjen e tyre brenda ambienteve të Bllokut Operator (sallave të operacionit).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
4. Kontrollin për mbylljen dhe vulosjen e objekteve.
5. Kur vëren se në Vr.Nr.8 ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.

X. Vendroja Nr.9. Ambientet e Brendshme të Ortopedise Kati i Parë 1 (një) turn 8 orarësh- Turn i parë – Orar zyrtar, Të shtunë Të Dielën dhe ditët zyrtare të festave Pushim.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Ortopedise se katit te parë.

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Ortopedise se Katit të Parë.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në koridor dhe futjen e tyre brenda ambienteve të Ortopedise se Katit të Parë (sipas orarit të vizitave).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
4. Kur vëren se në Vr.Nr.9 ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
5. Kryen detyrën me patrullim.

XI. Vendroja Nr.10. Ambientet e Brendshme të Ortopedisë Kati i Dytë, 1 (një) turn 8 orarësh- Turn i parë – Orar zyrtar, Të shtunë Të Dielën dhe ditët zyrtare të festave Pushim.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Ortopedisë së katit të dytë.

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Ortopedise se Katit të Dytë.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në koridor dhe futjen e tyre brenda ambienteve të Ortopedise se Katit të Parë (sipas orarit të vizitave).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
4. Kur vëren se në Vr.Nr.10 ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
5. Kryen detyrën me patrullim.

XII. Vendroja Nr.11. Ambientet e Brendshme të Neurokirurgjisë dhe ORL-së në Katin e Dytë të SUT-së, 1 (një) turn 8 orarësh- Turn i parë – Orar zyrtar, Të shtunë Të Dielën dhe ditët zyrtare të festave Pushim.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Neurokirurgjine dhe ORL-në së katit të dytë të SUT-së.

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Neurokirurgjisë dhe ORL-së.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në koridor dhe futjen e tyre brenda ambienteve të Neurokirurgjisë dhe ORL-së (sipas orarit të vizitave).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.

4. Kur vëren se në Vr.Nr.11 ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
5. Kryen detyrën me patrullim.

XIII. Vendoja Nr.12. Ambientet e Brendshme të Kirurgjisë së Parë, 1 (një) turn 8 orarësh - Turn i parë – Orar zyrtar, Të shtunë Të Dielën dhe ditët zyrtare të festave Pushim.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Kirurgjisë së Parë.

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Kirurgjisë së Parë.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në koridor dhe futjen e tyre brenda ambienteve të Kirurgjisë së Parë (sipas orarit të vizitave).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
4. Kur vëren se në Vr.Nr.12 ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
5. Kryen detyrën me patrullim.

XIV. Vendoja Nr.13. Ambientet e Brendshme të Kirurgjisë së Dytë, 1 (një) turn 8 orarësh - Turn i parë – Orar zyrtar, Të shtunë Të Dielën dhe ditët zyrtare të festave Pushim.

Ka në ruajtje:

1. Ambientet që përfshihen në shërbimin e Kirurgjisë së dytë.

Ka për detyrë:

1. Sigurimin e personelit mjekësor gjatë kryerjes së detyrës si dhe ruajtjen e rregullit dhe sigurisë në ambientet e Kirurgjisë së Dytë.
2. Moslejimin e grumbullimit të personave në koridor dhe futjen e tyre brenda ambienteve të Kirurgjisë së Dytë (sipas orarit të vizitave).
3. Mbrojtjen nga zjarri të objekteve.
4. Kur vëren se në Vr.Nr.13 ka shqetësime njofton kolegët dhe eprorët e vet që të marrin masa për eliminimin e shqetësimeve.
5. Kryen detyrën me patrullim.



SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

1. **Shërbimi që kërkohet:** Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë me Roje Private në SUT
2. **Afatet e ekzekutimit:** nga data e lidhjes së kontratës deri me 31.12.2017
3. **Tabele referuese per Analizen e koston per nje periudhe 329-dite (06.02.2017 - 31.12.2017)**

Nr	EMËRTIMI	VLERA / leke
1	Paga Baze minimale mujore e punonjësve në rethin e Tiranës që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik e fizik ,vëndas ose i huaj sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.573 dt.03.07.2013 (Pika nr.2- per 174 orë punë në muaj) si dhe në bazë të ligjit Nr. 75/2014 PËR SHËRBIMIN PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE (ku parashikohet shtesë 50% mbi pagën minimale)	
2	Shtesa mbi pagë për vështirësi shërbimi për ditët festive të turnit të II dhe të III sipas kodit të punës Neni 81, Ligji 7961, dt. 12.07.1995 turni II 19 ⁰⁰ -22 ⁰⁰ + 20% (721.06 lekë); turni i tretë 22 ⁰⁰ -06 ⁰⁰ + 50% (4807.1 lekë). <i>‘Përlllogaritjet janë bërë bazuar mbi pagën minimale ku një orë pune është 33000 lekë në muaj/174 orë pune mujore = 189.65 lekë’</i>	
3	Shuma e I –rë (1+2)	
4	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore është 27.9 % (pjesa që paguhet nga punëdhënsi është 16.7% dhe punëmarresi 11.2%).	
5	Shuma e II –të (3+4)	
6	Shpenzime për armatim të parashikuara në urdhërin Nr 3644 dt 07.12.2001 për tarifën e armës së krahut tarifën e municioneve, tarifën e leje mbajtjes. <i>Për llogaritjet mbi tarifën e armës është marë parasysh udhëzimi i APP-së (Rekomandim mbi menyren e zhvillimit te procedures se prokurimit per marrjen e sherbimit privat te ruatjes fizike, Dt. 01.04.2015) si dhe janë hequr nga përlllogaritja: shpenzimet për ndërlydhje dhe për uniformë (të pa parashikuara në udhëzim).</i>	
7	Shuma III (5+6)	
8	Fitimi I Shoqërisë 5%	
9	Shuma në Total	

Shuma pa TVSH për një punonjës roje (i një vendroje 8 orarësh) turn i parë për 1 muaj është përlllogaritur (duke patur parasysh që ky vendroje do të punojë sipas orarit zyrtar të administratës me fundjavën dhe ditët e festave pushim) si më poshtë:

Shuma për një roje (8 orësh) është e përlllogaritur mbi Pagën bazë, plus kontributet shoqërore, plus fitimin e shoqërisë.

TERMAT E REFERENCËS

“Shërbimi i ruajtjes me roje private, ne SUT”

1. Objekti dhe qellimi i shërbimeve:

Objektet e përcaktuara në specifikimet teknike do të ruhen nga rojet private të armatosura duke realizuar objektivat dhe detyrat e më poshtme.

Rojet të jenë të pajisur me armë dhe mjete të tjera mbrojtëse, me uniformë të vecantë dhe dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre. Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle cdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve

2.Objektivat: Të ruaj me përkushtim objektin që i është besuar, të ruaj rendin në to si dhe të sigurojë jetën e personelit.

3.Detyrat e përgjithshme (përvec atyre të përcaktuara në shtojcën 8):

Roja ka për detyrë:

- Të mos lejoje hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për cregullimet e konstatuara bën shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të kujdeset për ndricimin e jashtëm të objektit duke vënë në dijeni përgjegjësën e tij.
- Në rast zjarri merr masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset.
- Të kërkojë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brëndëshme të objektit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit,dhe njofton menjëherë organet kompetente.
- Roja (i vendrojes 24-oresh)perdor armën në bazë të gjithë legjislacionit në fuqi.
- Roja i objektit për kryerjen e detyrave të tij bashkëpunon me policinë e rendit.
- Roja për marjen e detyrës sipas grafikut duhet të paraqitet 15 min para.Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryerjes së shërbimit pa u zëvendësuar dhe pa marë miratimin e eproreve të vetë.
- Roja gjate kohes se sherbimit duhet te karakterizohet nga sjellja qytetare ne komunikim me personat.
- Rojës, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pijë alkolike, të flejë, të bisedojë me njëri-tjetër të jashtëm.
- Roja duhet të zbatojë vetem urdherat e përgjegjësit të rojeve dhe drejtorave përkatës.
- Në vend roje duhet të jenë keto dokumenta:
 - a-Libri i marrjes në dorezim të shërbimit.
 - b-Grafiku i shërbimit.

c-Inventari i materialeve që ndodhen në objekt.

d-Mjete ndricimi në rast mungese energjije elektrike.

e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.

f-Skemën e njoftimi në rast sulmi ose zjarri në objekt.

g-Listen e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.

-Rojes i ndalohen bisedat telefonike private.

-Roja për probleme urgjente të shërbimit përdor mjetet e ndërlikdhjes së objektit.

-Ndalohet ndërrimi i grafikut të shërbimit pa miratimin e përgjegjës të rojeve.

-Cdo lëvizje e personelit apo personave të tjere, shënohet në librin e shërbimit të rojes.

4. Shpërndarja: Të bëhet sipas objekteve dhe turneve të sipërpërmëndura, për të siguruar mbulimin e tyre me shërbimin e rojeve pa ndërprerje gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Shenim: kontraktuesi do të zbatojë të gjitha detyrimet që lindin nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi që rregullojnë fushën e ruajtjes dhe sigurisë të spitaleve. (ligje, VKM, UKM, rregullore etj)

